



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. prot  
5302/1

Tiranë më, 24/12/2018

VENDIM

Nr. 33 Datë 4/12/2018

**PËR**  
**MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI**  
**ELEKTRIKE NGA HEC DOMJA SUBJEKTIT “STARTEK” SH.P.K.**

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” të ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; Neni 50, pika 2, N.52 gërma c ; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015“Për miratimin e kushteve të përgjithshme të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni” ndryshuar me VKM Nr. 718, datë 12.10.2016, nenit 24, gërma “f”, me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “STARTEK ” SH.P.K. Keshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

VENDOSI:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “STARTEK ” SH.P.K. me administrator **Z.Lulëzim Mehmetaj**, për përdorim të rezervës ujore **në rrjedhën e sipërme të lumit Erzen** për prodhim energjie elektrike, në fshatin Shëngjergjegj bashkia Tiranë , Qarku Tiranë. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti per **HEC DOMJA** do të ketë këto të dhëna:  
Koordinatat e veprës së marrjes sistemi Gauss Kruger:

**X – 44 22 350 ; Y –45 77 220 ; Z- 545**

Koordinatat e veprës së marrjes sistemi KRGJSH:

**X-505940.038 ; Y- 4576674.784; Z 545**

Prurja mesatare:	<b>Q mes= 1,530 m<sup>3</sup>/sek;</b>
Prurja ekologjike:	<b>Q 355= 0.110 m<sup>3</sup>/sek;</b>
Sasia që do jepet në përdorim	<b>Q llog= 1.720 m<sup>3</sup>/sek.</b>
Prurja që shkarkohet:	<b>Q llog= 1.720 m<sup>3</sup>/sek.</b>
Fuqia e instaluar	<b>E= 1930 KW</b>

Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë  $Q_{\text{vaditëse}}=0.03 \text{ m}^3/\text{sek}$

Numri i oreve që do të shfrytëzohet – 3820 ne vit.

2- Autorizimi përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike,

3- Ngarkohet A.B.U Ishëm –Erzen për zbatimin e ketij vendimi.

### PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM ERZEN

**SEKRETAR**

**Dorina ÇAPUNE**



**KRYETAR**

**Suzana JAHOLLARI**

